



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL<sup>1</sup>

(I përmbledhur)

Tiranë, më 28.01.2019, ora 16.00

**Drejton mbledhjen**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

1. *Diskutimi dhe miratimi i Projektregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

#### **Marrin pjesë :**

- |                          |                        |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani        | (kryetar)              |
| 2. Vitore Tusha          | (zëvendës kryetare)    |
| 3. Fatri Islamaj         | (anëtar)               |
| 4. Margarita Buhali      | (anëtare)              |
| 5. Fatjona Memçaj        | (anëtare)              |
| 6. Eriol Roshi           | (anëtar)               |
| 7. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |
| 8. Medi Bici             | (anëtar zëvendësues)   |

<sup>1</sup>Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016 :**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Genci Gjonçaj, përfaqësues i kryetarit të Kuvendit.
3. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si përfaqësues i maxhorancës në Kuvend.
4. Enkelejd Alibeaj, zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si përfaqësues i opozitës në Kuvend.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :**

1. Anita Mihailova, eksperte e EURALIUS
2. Klodian Rado, ekspert i EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

**HAPET MBLEDHJA**

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Konstatohet mungesa e anëtares së Këshillit Arta Marku.

*Ardian Dvorani* informoi për njoftimin paraprak të anëtares Arta Marku mbi motivin e mungesës, një problematikë shëndetësore e papritur familjare, e cila pamundëson pjesëmarrjen në këtë mbledhje.

Për motive të komandimit në gjykime jashtë Tiranës, ishte e pamundur për anëtarin zëvendësues Gurali Brahimllari pjesëmarrja në këtë mbledhje.

*Ardian Dvorani* lexoi çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht :

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë pa ndryshime dhe shtesa të tjera rendin e ditës.

**Këshilli vijon mbledhjen** me punimet për pikën e parë të rendit të ditës.

**Ardian Dvorani**, përpara fillimit të diskutimit për projektregulloren, kërkon mendimin e anëtarëve të Këshillit nëse ka dakordësi që, përjashtimisht, procesverbali i mbledhjes së parë të Këshillit, të përpilohet duke zbardhur të plotë përmbajtjen e mbledhjes apo të përpilohet forma normale që përcakton ligji për përpilimin dhe bërjen publike të një procesverbali përmbledhës.

**Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit** diskutojnë dhe shprehin mendimin e tyre.

Në përfundim të këtij diskutimi, **anëtarët e Këshillit** u pajtuan me qëndrimin se, përjashtimisht, procesverbali i mbledhjes së parë të KED të përpilohet dhe publikohet duke e zbardhur të plotë përmbajtjen e kësaj mbledhjeje.

**Ardian Dvorani**, përpara fillimit të diskutimit lidhur me Projektregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, informon Këshillin se ditën e sotme ka depozituar pranë Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, qëndrimin përfundimtar për tërheqjen nga kandidimi në pozicionin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese. Motivi thelbësor është dhënia përparësi detyrës përkundrejt të drejtës kushtetuese për të kandiduar.

Në vijim, orientohet fillimi i diskutimit lidhur me Projektregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Së pari, paraqitet për diskutim mënyra se si do të procedohet me shqyrtimin e projektaktit, nëse do të diskutohet dhe miratohet në parim për të kaluar më pas në diskutimin dhe miratimin nën për nen të dispozitave të tij apo të kalohet drejtpërdrejt në shqyrtimin e përmbajtjes së dispozitave të projektaktit.

**Diskutojnë anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit dhe shumica shprehën mendimin që të kalohet menjëherë në diskutimin dhe miratimin nën për nen të dispozitave të Projektregullores.**

Këshilli fillon diskutimin e dispozitave të Projektregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

**Anëtarët e Këshillit diskutojnë** lidhur me titullin e Projektregullores dhe të dispozitave në mbështetje të të cilit përgatitet dhe miratohet projektregullorja.

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtron se Në nenin 230 i cili është neni që delegon në lidhje me bërjen e kësaj rregulloreje shprehet në mënyrë të posaçme, Këshilli i

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

Emërimeve në Drejtësi miraton një rregullore të brendshme për administrimin e brendshëm të tij dhe në këtë kuadër unë do të doja që edhe titulli të ishte në funksion dhe në kuptim të kësaj dispozite ishte propozimi që unë kisha. Prandaj, ndoshta organizimi dhe funksionimi më duket sikur është tej faktit, rregullorja është për administrimin e brendshëm. Ky do të ishte propozimi që neve kemi dhe e kemi të paraqitur edhe me shkrim në, që do të ishte ndoshta Këshilli i Emërimeve në Drejtësi miraton një rregullore, them organizimi dhe funksionimi i Këshillit rregullohet me ligj, nuk rregullohet me rregullore, në fakt e thotë Kushtetuta këtë gjë dhe prandaj gjithçka që është rregullim i bërë në ligj janë ato që janë funksioni një dhe organizimi, ndërsa ajo që mbetet për tu bërë nga ne në delegim, nga Këshilli më fal, në delegim të nenit 230 ka të bëjë me administrimin e brendshëm që duhet të jetë e ndryshme them unë rregullorja në lidhje me emërtimin që duhet të ketë. Mund të emërtohet rregullore e brendshme në lidhje me administrimin e brendshëm të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, propozimi që kemi ne, për sa kohë që neni 149 pika d pika 5 e Kushtetutës thotë organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj dhe këtë funksion, këtë emërtim domethënë ia ka dhënë ligji rregullores.

Parimisht unë nuk kam ndonjë kundërshtim dhe komenti që ne kishim të bënim kishte të bënte pikërisht mbi faktin se delegimi, baza mbi të cilin është nxjerrë kjo rregullore i referohet nenit 230, duke qenë neni 230 ngushtues edhe për efekt të teknikës legjislative dhe në fakt në thelb pastaj kur të shikojmë disa nga kompetencat që janë gjëra tërësisht të reja të paparashikuara nga ligji, mendoj se mund të na lindte problemi nëse e kemi apo se kemi të drejtë për të parashikuar një rregullim të posaçëm, ndryshe nga sa janë parashikimet ligjore në këtë rregullore. Pra kjo është po fillon që këtu dhe më pas prandaj e kemi bërë edhe në disa nga komentet tona. Edhe neni 229 pika 1 nuk referon në mënyrë të posaçme në një të drejtë për apo specifik një kompetencë në lidhje me delegimin e bërjes së ndonjë udhëzimi por referon sigurisht tek ligji për organet kolegjiale, kjo ndoshta është një problematikë e teksteve ndoshta do të, mund të kishte qenë e shkruar pak më mirë po që jemi në këtë moment edhe mendova që duhet ta evidentoja edhe më pas sigurisht jeni ju ata që e merrni vendimin në lidhje me këtë çështje

E kam te emërtimi dhe për faktin se dhe them emërtimi nuk mund të jetë ky, po do jetë ai që ka në delegim ligji së pari po dhe së dyti duhet të kemi parasysh dhe të jemi të kujdesshëm që Kushtetuta për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi duke qenë se është organ kushtetues e ka përcaktuar qartë që organizimi dhe funksionimi i saj rregullohen me ligj. Nuk thotë rregullohen

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

me ligj dhe ose rregullore. Kushtetuta e thotë këtë, që rregullohen me ligj. Prandaj duke pasur këtë lloj kufizimi duhet të jemi të kujdesshëm në përdorimin e termave mendova unë dhe prandaj e kemi bërë dhe propozimin pra 149/d e Kushtetutës thotë organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj, nuk thotë me ligj dhe rregulloren e brendshme të tyre. Për sa i përket diskutimit dhe referencës unë dua, e lidh së pari me kompetencën, ku merret kompetenca këtu për të bërë një rregullore dhe në këtë pikë aty referon dhe thotë rregullore të brendshme për administrimin e brendshëm të tij, përveç të tjerave e vërteta është që është në nenin 230 dhe unë nuk mund të, unë nuk kam as edhe një lloj mendimi që nuk duhet të keni as edhe një rregull të brendshme për të funksionuar, nuk e diskutoj, po duhet të jemi korrekt në çfarë, në moskrijimin e kompetencave të reja dhe delegimin që ligji nuk na e njeh dhe prandaj them në fillim të asaj dhe në emërtim që duhet të paktën korrekt në emërtim për sa i përket funksionimit.

**Enkelejd Alibeaj** kërkon fjalën dhe parashtron se do të mirëpriste të bëhej njëherë diskutimi në parim për sa kohë është një lloj veprimtarie normative. Megjithatë, KED nuk është i deleguar nga legjislatori rregulla shtesë tej atyre të ligjit nr. 115/2016 dhe ligjit për organet kolegjiale. Neni 229 është ezaurues. Neni 230 i referohet vetëm përgatitjes së rregullave të brendshme, madje edhe titulli i dispozitës është “personeli administrativ”. Duhet të respektohen kufijtë e neneve 118 dhe 119 të Kushtetutës, në rast të kundërt akti normativ është antikushtetues.. Por ligji nr. 115/2016 nuk i jep KED asnjë lloj delegimi që të miratojë rregulla shtesë për të tretët, për kandidatët, subjektet dhe publikun e që janë në kundërshtim me ligjin. Projektregullorja është totalisht në kapërcim të delegimit kushtetues dhe ligjor sepse duhet të ketë rregulla të cilat vlejné vetëm brenda për brenda.

**Ulsi Manja** kërkon fjalën dhe parashtron se për organizimin dhe funksionimin e KED, nenet 229 dhe 230 të ligjit nr. 115/2016 referojné rregullat e këtij ligji dhe për aq sa është e mundur ligji për organet kolegjiale. Çdo organ kolegjial e ka një rregullore por nuk mendoj që rregullorja mund të përcaktojë norma të reja. Prandaj e vlerësoj korrekt përcaktimin e objektit në nenin 1 të kësaj projektregulloreje. Por, gjithsesi, bie dakord që kjo KED do të ketë një rregullore të brendshme dhe ky KED ka përbërje të tillë që e dinë se një akt nënligjor nuk përcakton norma të reja.

**Bledar Dervishaj** kërkon fjalën dhe parashtron se që duhet të ketë një rregullore të brendshme patjetër që do të ketë, tjetër gjë në qoftë se do ketë një rregullore apo katër. Pasi ligji

115 thotë për katër. Do e shikojmë në detaj gjithë kreun që rregullon organizimin dhe funksionimin e KED, duke e filluar që me kreun e parë i cili përcakton parimet, rregullat, procedurat, dhe funksionin e KED.

Por të shkojmë tek 228 pika 3 ku përjashtimisht thotë ligji nëse sistemi elektronik nuk punon atëherë KED miraton rregulla më të detajuara. Vijnë tek 229 pika 2, ka një tjetër rregullore për përzgjedhjen e kandidatëve. Të vijnë tek 230 kjo që po diskutojmë përcaktohet se miraton një rregullore të brendshme, për administrimin e brendshëm dhe 240 pika 6 (*citohet norma*). Pra dalin katër, pra labirinti që ka lënë Kushtetuta dhe ligji është aq i hollë dhe detajuar sa që i ka përcaktuar qartë mënyrat e organizimit dhe funksionimit të KED dhe tek ky kre.

Prandaj duhet të qëndrojmë strikt tek neni 230 apo tek vërejtja e Avokatit të Popullit del e drejte. Por mendoj që ndoshta edhe përmbajtja e rregullores është vetëm për administrimin brendshëm të këtij Këshilli dhe e mbështes këtë propozim të Avokatit të Popullit pasi me duket e drejtë.

*Genci Gjonçaj* kërkon fjalën dhe parashtron se legjislatori e ka paraparë përbërjen e KED nga e gjithë sistemi i drejtësisë, nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Larte, Prokuroria etj., dhe më mire se ju nuk mund ta bisedojnë dhe ta trajtojnë çështjen të tjerët. Të trajtohet me kujdes problemi që parashtrroi Avokati i Popullit nëse ka përcaktime që bien ndesh me kuadrin ligjor.

*Ardian Dvorani* shtron për diskutim dhe qëndrim për anëtarët e Këshillit natyrën e projektregullores, bazueshmërisë në ligj.

*Diskutojnë dhe shprehin mendimin e tyre anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit.*

*Në përfundim, Këshilli vendosi unanimisht që akti të titullohet “Rregullore e Brendshme për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

*Ardian Dvorani* shtron për diskutim dhe qëndrim përmbajtjen e dispozitave, nen për nen të projektregullores.

Neni 1 “Objekti i Rregullores”.

*Miratohet nga anëtarët e Këshillit duke hequr nga përmbajtja fjalën “organizimin”.*

Neni 2 “Përkufizime”.

*Diskutojnë anëtarët e Këshillit, Avokati i popullit dhe subjektet e ftuar.*

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

*Në përfundim, Këshilli vendosi të konsiderojë përmbajtjen e këtij neni në fund të procesit të miratimit të dispozitave të rregullores në varësi të nevojës dhe dobisë së përkufizimeve në këtë projektakt.*

Neni 3 “Selia e Këshillit”.

*Miratohet nga anëtarët e Këshillit duke saktësuar dhe plotësuar adresën zyrtare.*

Neni 4 “Vula e Këshillit”.

*Miratohet nga anëtarët e Këshillit duke pasur parasysh se diskutimet mbi mënyrën e përdorimit të vulës do të gjejnë rregullim në akte të tjera nënligjore si edhe bazuar në legjislacionin në fuqi.*

Titulli i Kreut II.

*Miratohet nga anëtarët e Këshillit me këtë formulim: “Funksionimi i Këshillit”.*

Neni 5 “Kostituimi i Këshillit”.

*Diskutojnë anëtarët e Këshillit.*

*Enkelejd Alibeaj* kërkon fjalën dhe parashtron se ky formulim në pikën 1 i tejkalon tagrat e KED. Sipas Kushtetutës, kostituimi bëhet nga 9 anëtarë e të cilët duhet të jenë prezent në momentin pasi zgjedhja ka përfunduar sipas procedurës nga Presidenti ose Kuvendi. Askush nuk ka te drejtë të tejkalojë këtë rregull kushtetues. Për më tepër që është lëndë e cila nuk rregullohet prej një rregullore të brendshme. Është dispozitë që tejkalon ligjin dhe Kushtetutën. Pika e dytë e këtij neni që Këshilli mblidhet së paku deri në javën e tretë sjell vetëkufizim të anëtarëve për tu mbledhur kjo në kundërshtim me Kushtetutën që përcakton veprimtarinë e Këshillit gjatë vitit kalendarik 1 janar 31 dhjetor.

*Në përfundim të diskutimit, anëtarët e Këshillit vendosën miratimin e nenit 5, me rezervën që pika 3 e këtij neni, të konsiderohet nëse është rregull i nevojshëm në fund të procesit të miratimit të dispozitave të rregullores.*

Neni 6 “Mandati i anëtarit dhe anëtarit zëvendësues të Këshillit”.

*Diskutojnë anëtarët e Këshillit.*

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtron se Lidhur me nenin 6, Avokati i Popullit ka disa komente dhe komenti I pare ka te beje me faktin nëse e ka apo jo këtë kompetencë ky Këshill për sa I përket çështjes se mandatit, për këtë kemi bere një qëndrime me shkrim sepse mendojmë qe pika e dyte e nenit 6 nuk është në harmoni me nenin e 118 të Kushtetutës, mandatin nuk ja delegon KED për ta përcaktuar apo për ta trajtuar në lidhje me faktin e mbarimit

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

të mandatit është një moment shumë i rëndësishëm për ne. Dhe nga ana tjetër edhe sikur të supozonim se në rastin teorik KED-ja mund ta kishte këtë kompetencë të përcaktimit të fillimit apo të mbarimit të mandatit të vet mendojmë se cila do të ishte detyrimi që do të lindte mbi bazën e KLGJ-se apo të KLP-se për të bërë një deklaram të tillë nëse në nenet përkatëse të kompetencave të KLGJ apo të KLP kishte, një parashikim në lidhje sidomos në pikën b, në paragrafin b të pikës 2. Në qoftë se personi nuk e gëzon më statusin e gjyqtarit apo prokurorit kjo është e qartë që s'ka nevojë ta deklarojë KLGJ apo KLP se mos gëzimin e statusit gjykojmë se fakti që i mungon statusi i gjyqtarit apo prokurorit është e mjaftueshme që mund ta deklarojnë edhe organet e vettingut p.sh.. Dhe një nga rastet që ka ndodhur që asnjë prej anëtarëve nuk ka marrë pjesë d.m.th. ka qenë një nga rastet, edhe në këtë Këshill ka anëtarë që nuk janë paraqitur për këtë shkak por nuk ka deklarim të KLGJ apo të KLP çdo te thotë me këtë rast ato do jenë këtu derisa ne te marrim letra nga KLGJ apo KLP nëse ato do ta kishin këtë kompetencë ? Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë me problematike ka të bëj me interpretimin e nenit 221 të ligjit 115/2016. Çfarë do të ndodhte në rastin konkret se këtu supozohet po behet fjale për përfundim të mandatit ku është deklaruar se mandati i përfituar do të thotë që me këtë po bëjmë një parashikim, që në çdo moment organi i KLGJ ose organi I KLP mund të gjykojë që kandidati nuk plotëson një nga kushtet e nenit 221. Presupozohet që këto rregullime janë bërë paraprakisht dhe presupozohet se sipas procedurës ligjore që KLGJ apo KLP kanë shpallur secili, pavarësisht se këtë radhe procedurën e kane kryer Prokurori I Prokurorisë së përgjithshme apo Kryetari i Gjykatës së Lartë nëse kandidati ka plotësuar kriteret. Sepse kriteret lidhen me momentin e tyre te krijimit pra nëse në momentin e shortit i plotësojnë këto kriteret, ligji është i qartë për këtë, nuk thotë që ne momentin që këto kriteret duhet të jenë në fuqi edhe pas hedhjes së shortit përgjatë gjithë vitit kalendarik . Do të ishte hipotetik rasti që e bën këtë organ nën një te themi detyrim të verifikimit të vazhdueshëm nga ana e KLGJ apo KLP-se në mënyrë të veçantë në lidhje me dy kriteret që unë po i sjell si shembull me dy kriteret të cilat në momentin e shortimit mund të ketë plotësuar kandidati, por nuk i plotëson më pas, gjatë vitit kalendarik. Një e tillë mund të jetë p.sh. dy vlerësime pozitive për vitet e fundit mundet që gjatë vitit kalendarik KLGJ bën një vlerësim tjetër i cili nuk do të thotë që nuk e ka ky mund të mos e plotësojë. I bie te mbarojë mandati. A do ndryshojë, a do iki anëtari? Këto janë kriteret që varen nga KLP dhe KLGJ. Njëra mund të jetë masa disiplinore. Dhe mundet të funksionojë si një mënyrë për të mos p.sh. për të mos lejuar

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*



anëtarin të vazhdojë të jete në këtë detyrë mundet kjo. Tjetër pse themi se mund të jete problem në lidhje me këtë pikë sidomos me pikën B Sepse ligji ka parashikuar të drejtën e ankimit kundrejt vendimit të KLGJ apo KLP që nuk kandidon një individ i caktuar në të ardhmen nëse vërtetë nuk e patëm mundësinë e ankimit në këtë procedurë të zgjedhjes së këtyre anëtareve të këtij këshilli por rregullorja nuk behet për një vit behet në parim dhe kur e bëjmë duhet të parashikojmë këtë mundësi. Çdo ndodhë kur KLP thotë që Erinda nuk do kandidojë sepse nuk plotëson kushtet. Erinda ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, e fiton gjyqin dhe kandidohet futet në short dhe përzgjidhet gjithmonë nga KLGJ e KLP, gjithmonë nëse këto dy organe kanë menduar se sduhet të kandidojë dhe përsëri këto organe çojnë letër e thotë nuk I përmbush kushtet prapë për neve, e për ta çuar çështjen deri në fund apo i shton një masë disiplinore dhe do duhet të ishim shumë të kujdesshëm me këtë çështje të rrimë strikt neni (citohet neni). T'i rrimë strikt neni që thotë që në momentin e kandidimit, të shortimit personat do të plotësojnë këto kritere dhe çfarë do ndodhte në themel, p.sh. kemi në këtë këshill që nuk plotëson një nga kriteret e këtij neni e çfarë do bëjmë do presim që të na deklarojë KLGJ këtë fakt? Kështu e ka shkruajtur si tja bëjmë, tani diskutimi është se duhet ta bëjmë Thuhet anëtari nuk qëndron në detyrë në rastet dhe për pjesën e mbetur të vitit kalendarik zëvendësohet nga anëtari zëvendësues nëse ka, dhe në rastet kur sipas vendimit të KLP KLGJ nuk përmbush një nga kushtet e këtij neni.

Rasti i zotit Bici, ai nuk është se nuk përfaqëson më Gjykatën e Lartë se ka vajtur dhe bënë një detyrë, do të rikthehet në detyrë në Gjykatën e Lartë, teorikisht është i përjashtuar. Por mund të ketë raste të tjera që nga shkalla e parë shkojnë në apel apo nga apeli shkojnë në Gjykatën e Lartë apo nga Gjykata e Lartë shkojnë në Gjykatë Kushtetuese kështu që ndoshta nuk rregullohen në këtë rregullore por do të ishte me vend të ngrihej si problem që ekziston në do ta kemi pjesë të raportit tonë vjetor. Do ishte mirë që të rregullohej kjo çështje që të mos na mbeste ky problem.

Do propozoj ta heqim fjalën për pjesën e mbetur të mandatit dhe t'i vëmë pikën aty. Pastaj të themi në rast të ndërprerjes duke përcaktuar ndërprerjen në rast të ndërprerjes zëvendësimi është për gjithë pjesën e mandatit për këtë merakun që ka lindur që ka pasur vërtetë problem për funksionimin e KED-së për shkak të këtij problemi që nga kryetari i parë parimisht

Kohëzgjatjen për të gjithë pjesën e mbetur të mandatit ta lidhim vetëm kur ndërpritet dhe jo në rastet e pezullimit apo të pengesave ligjore që e kuptojmë që vetëm në rastin e ndërprerjes

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

është e përhershme zëvendësimi deri në, kthehet pra në një person me mandate të përhershëm. E them këtë sepse ka pasur disa problem qëndrime të anëtarëve të cilët thonë nëse anëtari që unë zëvendësoj e humbet përherë mandatin unë nuk mund të kthehem, nuk mund të kthehet një anëtar zëvendësues automatikisht në një anëtar të përhershëm. Ky është qëndrim që është qëndrim individual, tani secili ka mendimin e vet. A mundet anëtari zëvendësues të shndërrohet në anëtar të përhershëm nëse sepse koncepti i zëvendësuesit ka një qëndrim. Ka një qëndrim të mbajtur institucionalisht dhe KED-ja e parë s'ka funksionuar fare nuk është mbledhur asnjëherë për këtë shkak.

**Enkelejd Alibeaj** kërkon fjalën dhe parashtron se ky është rasti klasik i tejkalimit flagrant të kompetencës së një organi të padeleguar nga Kushtetuta e Ligji që të vendosë rregulla për të tretë madje të nivelit kushtetues. Është guxim i madh. Pika 2 përsërit Kushtetutën, është në rregull por është e mangët. Neni 221 i ligjit 115 ka përcaktuar një sërë kushtesh të cilat të bëjnë të aftë për tu zgjedhur në KED. Ka edhe një kusht tjetër shumë të rëndësishëm që është në trupin e pikës 1 dhe duhet të jetë magjistrat dhe gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, kusht pa të cilin nuk mund të zgjidhesh. Nëse aftësia për tu zgjedhur është kusht pa të cilin nuk mund të hysh në një organ, domosdoshmërisht do të duhet ta ruash deri me 31 dhjetor të atij viti, përndryshe ka defekt në mandatin dhe investiturën tënde. Së treti, është akoma më i rëndësishëm dhe që buron nga Kushtetuta, fakti që cilësia “magjistrat” apo gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë e tillë dhe e lidhur me përbërjen që përcakton neni 149/d i Kushtetutës. Është kusht i domosdoshëm dhe fryma e Kushtetutës diversifikimi i burimeve se nga duhet të vijë përbërësit e KED. Po trajtoni një çështje që nuk është në tagrin e KED. Ky sjell efektin edhe tek neni 7. Secili kur vjen si anëtar i rregullt në KED ia di për nder investiturës që ka marrë prej procesit përzgjedhës që është finalizuar ose në Presidencë ose në Kuvend dhe që ka filluar sipas procedurës ligjore me listat e përgatitur nga KLP, KLGJ dhe nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Qoftë edhe një parashikim të brishtë të vendoset në rregullore, pezullim apo ndërprerje, implikimet të çojnë në paradoks. Ndërkohë që nuk është lënda e KED nëse ka mangësi në ligj. Ne jemi këtu edhe për këtë arsye për të korrigjuar eventualisht çështjet që zbatimi i ligjit dalin problematike.

#### ***Diskutojnë anëtarët e Këshillit.***

***Në përfundim të diskutimit vendosën miratimin e nenit 6 të projektrregullores, të riformuluar me disa shtesa dhe ndryshime.***

Neni 7 “Vazhdimësia e detyrës së anëtarit të Këshillit”.

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi***

### *Diskutojnë anëtarët e Këshillit.*

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtrohet se a duhet KED të ruajë përbërjen pavarësisht faktit të përfaqësimit të interesave të atyre grupeve kur është bërë përzgjedhja e anëtarëve. Nuk mjafton sa është parashikuar në Kushtetutë për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së, por do të duhet të kemi edhe ligjin. A do duhet KED ta ruajë këtë përfaqësim gjatë gjithë veprimtarisë së saj njëvjeçare apo vetëm në momentin e parë të emërimit?

Qëndrimi është që realisht kjo është tej kapaciteteve tona për ta vendosur dhe do duhet të ketë një rregullim ligjor. Për sa kohë nuk ka një rregullim ligjor duhet të vazhdojmë në mënyrën më të mirë të mundshme ndoshta, por që ka nevojë për rregullim në lidhje me këtë çështje që të mos mbetet në dorën e Këshillit. Këtu kemi problem me gjyqtarë apo prokurorë sepse sipas këtij përkufizimi nëse zoti Bici do të zgjidhet në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese do të binte që kjo dispozitë nuk do të zbatohet për të sepse Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit gjyqësor dhe ka një rregullim në çdo dispozitë të ndryshme. Kjo do jetë një nga pikat që ne do t'i bëjmë propozim Kuvendit që të ndërhyjë në legjislacion për ta sqaruar edhe këtë moment. Po në qoftë se anëtarët dalin fare nga funksioni, nga sistemi? Se kështu i bie që pavarësisht që dolëm fare nga sistemi, domethënë bëhem diplomat, përsëri vazhdojmë edhe këtu.

**Enkelejd Alibeaj** kërkon fjalën dhe parashtrohet se argumenti për këtë dispozitë është të garantohet funksionaliteti i KED. Por, askush nuk i ka dhënë KED të drejtën të mendojë për funksionalitetin e tij. Anëtarët kanë vetëm detyrimin të marrin pjesë në mbledhjet e KED-së. Çështja e funksionalitetit e vazhdimësisë është lëndë kushtetuese, minimalisht lëndë ligjore. Ligji është i paplotë. Nëse do të qëndroj një dispozitë e tillë qoftë edhe e modifikuar nuk është asgjë veçse shtrirje dore për të bërë pazar për tu promovuar. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi duhet të jenë të pavarur në punën e tyre dhe kjo është një nga ato vlerat kryesore që e mban Kushtetutën edhe gjithë sistemin e drejtësisë në këmbë.

**Ulsi Manja** kërkon fjalën dhe parashtrohet se në kuptim dhe në frymën e ligjit është që vazhdimësia e funksionit për të qenë anëtar i KED nuk kushtëzohet nga mundësia e lëvizjes së tij në detyrë por lidhet me ruajtjen e statusit të gjyqtarit dhe prokurorit. Bëhet fjalë për një organ kushtetues me mandat njëvjeçar dhe është zëvendësuesi që ushtron detyrën me të njëjtat tagra dhe që funksionimi është i lidhur me një kuorum. Vetëm në këtë moment kur bie numri ky Këshill ka vdekur juridikisht. Nuk besoj se është rregullorja që duhet të plotësojë ligjin.

Pjesëmarrja në mbledhje dhe veprimtaritë e KED është e detyrueshme edhe nëse e ndryshon nivelin e përfaqësimit për të cilën je zgjedhur në Këshill.

***Diskutojnë anëtarët e Këshillit.***

***Në përfundim të diskutimit vendosën të hiqet neni 7 nga kjo projektregullore.***

Neni 8 “Detyrimi i pjesëmarrjes në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit”

***Diskutojnë anëtarët e Këshillit.***

***Në përfundim të diskutimit vendosën miratimin e nenit 8 të projektregullores, i cili bëhet neni 7, të riformuluar me disa shtesa dhe ndryshime.***

Titulli i Seksionit 2 riemërtohet “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi”.

Neni 9 “Kompetencat e mbledhjes së Këshillit”

***Diskutojnë anëtarët e Këshillit.***

***Enkelejd Alibeaj*** kërkon fjalën dhe parashtron se kjo dispozitë dhe sidomos dispozitat që janë në vijim 10, 11, 12 *së pari*, kanë të njëjtën simptomë, përsërisin ligjin dhe me mangësi. *Së dyti* në përmbajtje të kësaj dispozite është sëmundje shqiptare në organet kolegjiale për një varësi psikologjike ndaj atij që zë karrigen e kryetarit. Ka disa paragrafë që kryetari ndryshe nga pjesa tjetër merr kompetenca duke ia uzurpuar kolegjalitetit Këshillit që nga rendi i ditës që e përcakton kryetari. Dispozitat e kryetarit janë përcaktuar në mënyrë ezauroese në nenin 226 dhe mbyllet me një banket, po gjithmonë ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj. Gjykata Kushtetuese është shprehur se çfarë janë kompetenca të shkruara në ligj për organin kolegjial do t’i ushtrojë së bashku dhe jo në mënyrë të parcelizuar. Në rregulloren e brendshme duhet të rregullohet rendi i ditës ku duhet të marrin pjesë paraprakisht të gjithë anëtarët dhe e formalizon kryetari.

***Në përfundim të diskutimit anëtarët e Këshillit vendosën miratimin e nenit 9 të projektregullores, i cili bëhet neni 8, të riformuluar me disa shtesa dhe ndryshime.***

Neni 10 “Përgatitja e mbledhjeve të Këshillit”

***Diskutojnë anëtarët e Këshillit.***

***Erinda Ballanca*** kërkon fjalën dhe parashtron se neve kemi paraqitur komentet me shkrim në lidhje me këtë çështje. Mendoj se përgatitja e mbledhjeve të Këshillit duhet të ndjekë frymën e ligjit për organet kolegjiale i cili përcakton kompetencën e kryetarit në raport me anëtarët e tjerë pra që sipas dispozitave për sa i përket çështjeve të rendit të ditës duhet të mblidhet domosdoshmërisht edhe mendimi i anëtarëve në lidhje me përcaktimin e rendit të ditës

për të përfshirë ato pika të rendit të ditës që secili prej anëtarëve dëshiron që të përfshihen. Ndërkohë që kishim një koment tjetër në lidhje me pjesën e fundit të fjalisë të pikës 2 aty ku flitet për ata që kanë marrë vetë përsipër për përgatitjen e materialeve të mbledhjes. Nuk e kuptoj.

Kam bërë komente lidhur me këtë nen edhe nisur dhe nga praktika e vazhdueshme e organeve kolegjiale ose ajo eksperiencë që unë kam pasur gjatë trajtimit të mbledhjeve të Këshillave të Asambleve nëpër shoqëritë tregtare dhe këtu ka qenë gjithmonë truku dhe problemi që kishin anëtarët me administratorët për shembull apo aksionarët me administratorët. Ka qenë gjithmonë një problem dhe prandaj them që nisur nga këto problematika që kemi pasur, duhet pasur kujdes që të kemi referencë në ligj. Çfarë duhet të garantohet? Duhet të garantohet e drejta e secilit prej anëtarëve për të propozuar pika të rendit të ditës. Dhe të mos jepen të mos diskutohen për sa i përket materialeve sigurisht ka një zgjidhje dhe themi propozohet kjo pikë e rendit të ditës nga anëtari Fatjona Memçaj po them një emër s'ka rëndësi, nëse ajo mundet futet në rendin e ditës, nëse është e papërgatitur do të shtyhet për tu trajtuar në ditën që do përgatiten materialet. Mund të jetë njëra gjë që s'është krejtësisht e pamundur teorikisht, po mundësia për tu futur në shqyrtim një çështje

Kjo është ajo që është garancia kryesore. Për materialet pastaj do ketë një vlerësim të dytë që do të merret sigurisht dhe nga gjithë të tjerët se duhet të jetë një vlerësim që duhet parë për sa i përket kapaciteteve reale dhe do të shqyrtohet rast pas rasti. Por siç është shkruar teksti i rregullores krijon problem pra edhe kundërshti me ligjin për organet kolegjiale dhe me frymën e përgjithshme për faktin se çfarë çështje do t'i nënshtrohen për vendimmarje Këshillit dhe a ka secili prej anëtarëve të drejtën që të propozojë çështje për tu trajtuar në Këshill. Kështu që këto ishin pikëpyetjet më të mëdhaja që doja të adresoheshin në lidhje me këtë nen.

Ta sqaroj çfarë ndodh nga për shkak të praktikës e për propozimi ose të themi rregullimi më i mirë që unë kam parë në lidhje me këto rregullore mund të mos kem parë shumë ose me këto rregulla ka të bëjë me garantimin e përfshirjes në rendin e ditës të çdo pike që propozon ndonjëri prej anëtarëve. Kjo është ajo që duhet të, pra neve do themi, nuk ka problem të themi që rendi i ditës përcaktohet nga kryetari por do të shtosh një gjë: çdo çështje e cila është propozuar me marrjen e këtij drafti secili prej anëtarëve ka të drejtë të propozojë çështje të tjera në rendin e ditës. Kjo është se duhet të garantosh të drejtat e tyre për të propozuar për tu përfshirë në rendin e ditës të çështjeve të tjera. Faleminderit.

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

Ne nuk i kemi mbledhje të rregullta. Në momentin që një organ kolegjal vendos mbledhje të rregullta mund të jetë e përcaktuar kjo. Pra duhet të kemi një datë të vendosur se së pari kur do mblidheni sepse nuk kemi asnjë vendimmarrje të këtij organi, në gjykimin tim, se si do të mblidheni. Për shembull në disa organe të tjera kolegjiale dihet se çdo të enjte ka mbledhje. P.sh të Këshillit të Ministrave apo në një organ tjetër të një natyre tjetër dhe aty dihet se kur janë apo kur nuk janë mbledhjet e Kuvendit apo gjërat e tjera. Prandaj ndoshta është bërë ky parashikim duke u nisur nga kjo gjë. Duke qenë se ne jemi një organ *ad hoc* të themi që mblidhet vetëm në rast se ka kandidatura për tu shqyrtuar, duhet ta përcaktojmë ndoshta dhe vetë këtë çështje.

*Enkelejd Alibeaj* kërkon fjalën dhe parashtrohet se është e rëndësishme që të rregullohen problemet për fazën para mbledhjes. pra si bëhet propozimi për një pikë apo disa të rendit të ditës, kur depozitohet, sa kohë para mbledhjes, si komunikohet dhe shkëmbehet informacioni, këto për të garantuar të drejtat e anëtarëve të tjerë dhe që të mos dështojë mbledhja. Çështja se kush ka të drejtë të kontribuojë në rendin e ditës është e përcaktuar në ligj. Kryetari vetëm i mblidh të gjitha propozimet. Në mbledhje kur vëren se çështja është jashtë logjikës Kryetari e hedh në votim.

*Anëtarët e Këshillit, pas diskutimeve mes tyre, vendosën që të ndërpritet mbledhja dhe të vijojë diskutimi i mëtejshëm i dispozitave të projektregullores ditën e premte, 01.02.2019, në orën 10.*

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani* duke shpallur zhvillimin e mbledhjes së radhës në datën 01.02.2019, ora 10.00 me këtë rend dite, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

## **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 20.21**

**Sekretari**

**Kryetari**

**Redjona Myrtja**

**Ardian Dvorani**

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*